



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. 192 Prot.

Patos, më 16/01 /2026

NJOFTIM

Në mbështetje të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, si dhe udhëzimin nr. 1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar, njoftojmë subjektet e interesuara për ofrimin e shërbimit të transportit për linjën “**Patos-Kuqar**” të shprehin interesin duke dorëzuar dokumentacionin përkatës.

Kriteret përcaktuese për shpalljen e fituesit do të jenë:

1. Të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
2. Të ushtrojë aktivitetin brenda juridiksionit të Bashkisë Patos;
3. Dokumentacioni teknik shoqërues i mjetit (Leje Qarkullimi, Çertifikatë kontrolli teknik, Policë sigurimi për mjetin, Policë sigurimi për pasagjerët nga aksidentet rrugore) të vlefshme për vitin kalendarik aktual;
4. Akt-vlerësimi për plotësimin e kushteve të komoditetit të mjeteve që do të përdoren për transportin rrugor;
5. Çertifikatë për kalibrimin e tahogرافit të mjeteve të deklaruara;
6. Të ketë të deklaruar minimumi 2 mjete (autobus), për lëvizjen vajtje-ardhje;
7. Të ketë shlyer detyrimet vendore dhe tatimore në Bashkinë Patos;
8. Subjektet duhet të deklarojnë drejtuesin e mjetit të pajisur me leje drejtimi të kategorisë D dhe D1, kontratën e punës, vërtetim për reputacionin e mirë, dëshmi penaliteti, për çdo drejtues mjeti;
9. Dëshmi penaliteti për administratorin e subjektit;

Afati për shprehjen e interesit dhe dorëzimin e dokumentacionit do të jetë data 06/02/2026, pranë Zyrës me një ndalesë, Bashkia Patos.